



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:161285
Datë: 16.04.2024
Numri i dokumentit: 05577220

PAKR.nr.417/2023

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku - kryetar, Xhevdet Abazi dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ardianë Morina, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. M. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, duke vendosur për ankesën e Prokurorisë Themelore - DKR në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Mitrovicë, P.38/2007 i datës 04.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, më datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Mitrovicë, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Mitrovicë, P.38/2007 i datës 04.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKR në Mitrovicë, P.38/2007 të datës 04.07.2023, është refuzuar akuza e prokurorisë, kundër të akuzuarit I. M., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, me arsyetim se për veprën e lartë cekur penale ka arritur afati i parashkrimit relativ i ndjekjes penale, kuptohet, pasi më parë, gjykata e shkallës së parë, e ka bërë rikualifikimin e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, për të cilën ka qenë i akuzuar me aktakuzën e prokurorisë i akuzuari I. M., e më pastaj, ka gjetur se i njëjti e ka kryer veprën penale

mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, e duke konstatuar më pas, pastaj, se pasi për këtë vepër penale ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale, për çka, edhe është refuzuar akuza e prokurorisë e paraqitur kundër të akuzuarit I. M..

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në procedure kontestimore.

Shpenzimet e procedurës penale kanë mbetur barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK-së, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të akuzuarin I. M. dhe mbrojtësin e tij, av. Gani Rexha. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm mbrojtësi i ta akuzuarit av. Gani Rexha, ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantoi Prokuroria e Apelit e as i akuzuari I. M. Në seancën e kolegjit, mbrojtësi i të akuzuarit av. Gani Rexha, pasi më parë bëri disa nga vërejtjet në ankesën e prokurorisë, i propozoi gjykatës që ankesa në fjalë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.386/2023, të dt. 14.07.2023, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë, ashtu që, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Me ankesën e prokurorisë, përkitazi me këtë bazë ankimore, pra, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur për të akuzuarin I. M., ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, në vepër penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, ngase, përkitazi me këtë nuk ka arritur që në arsyetim të jap arsye të mjaftueshme dhe të bindshme përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale-juridike, që kanë të bëjnë, me ricilësimin e veprës penale për të akuzuarin I. M.. Kështu, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 10 të KPPK-së, kur, ka bërë ricilësimin e veprës penale pasi që është bazuar vetëm në deklaratat e të akuzuarit, provat që i ka paraqitur i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, e jo edhe në provat e prokurorisë, e duke mos marrë kështu, fare parasysh sidomos deklaratat

e palës së dëmtuar - dëshmitarit A. K., dëshmitarëve A. K., S. K., B. T. dhe M. M., por, edhe provave materiale, ku, vërtetohet se tek i akuzuari ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale të vrasjes, prandaj, me vetë faktin që ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 380 par. 1 nën par. 10 të KPPK-së. Më tutje, në ankesë vazhdohet me konstatimin se gjatë marrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e njëjta, nuk ka marr për bazë fare dëshminë e të dëmtuarit A. K. të dhënë në polici, pastaj, dëshminë e dëshmitarëve S. K., B. K. dhe B. T., po ashtu, të dhëna në polici, ku, të gjithë këta kanë konstatuar se ditën kritike pas një konflikti paraprak që ka ndodhur në rrugën “Sami Gashi, “ në Mitrovicë, në mes të dëmtuarit A.K. dhe të akuzuarit I. M., nga ana e të akuzuarit I. M., është shtënë me armë zjarri në drejtim të dëmtuarit A. K., me qëllim që të njëjtin ta privojë nga jeta, veprime këto pra nga të cilat vërtetohet dashja e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale në fjalë, prandaj, me vetë faktin që gjykata e shkallës së parë, e ka rikualifikuar veprën penale në fjalë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për çka, edhe propozon anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore në fjalë nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, përveç, që ka bërë ricilësimin e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, në veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, e njëjta, - pra, gjykata e shkallës së parë, edhe në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ka përfshirë të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit I. M., që përbëjnë elementet e veprës penale, për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, pra, dispozitivi është përpiluar konform dispozitave ligjore të parapara sipas dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, dhe po ashtu, veprimet inkriminuese të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, janë në përputhje të plotë edhe me emërtimin ligjor të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, që do të thotë se dispozitivi nuk është në kundërshtim me emërtimin ligjor të veprës penale dhe se gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur ka bërë një ricilësim të tillë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, sidomos, kur e ka konstatuar se në rastin konkret nuk vërtetohet dashja e të akuzuarit për privimin nga jeta të dëmtuarit, për çka, edhe me të drejtë është konstatuar se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për dashjen për privimin nga jeta të dëmtuarit, sikur që kërkohet sipas dispozitave të nenit 146 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së, ku, edhe është paraparë figura e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, ku, parashihet se për të ekzistuar vepra penale në fjalë, duhet të vërtetohet dashja e të akuzuarit për privimin nga jeta të dëmtuarit, gjë që, një gjë e tillë, përveç, që është mohuar nga i akuzuari nuk është vërtetuar as nga dëshmitarët okular në vendin e ngjarjes, e që po ashtu, vërtetohet edhe nga vetë mënyra e ndërmarrjes së veprimeve inkriminuese të akuzuarit, pra, kur, merret parasysht edhe afërsia e të akuzuarit me të dëmtuarin si dhe faktin se i akuzuari me armën e tij, nuk e ka goditur fare të dëmtuarin, gjë, që, ka mundur ta bëjë shumë lehtë nëse merret parasysht distanca, por, edhe fakti se i njëjti nuk ka qenë i penguar nga askush. Prandaj, përveç, që dispozitivi është në përputhshmëri të plotë me emërtimin ligjor të veprës penale, i njëjti - pra, dispozitivi ka mbështetje po ashtu, edhe në provat dhe shkresat tjera të lëndës dhe atë, sidomos, në deklaratat e dëshmitarit - të dëmtuarit A. K., dëshmitarëve A. K., S. K., B. T. dhe M. M., e që të gjitha këto deklaratat, po ashtu, kanë mbështetje edhe në provat materiale në shkresat e lëndës, fakte këto dhe rrethana që nuk i ka kontestuar as vetë i akuzuari I. M., por, natyrisht duke e mohuar se dashja e tij ka qenë që ta privojë nga jeta të dëmtuarin, me arsyetim se me armë zjarri ka shtënë në ajër me qëllim që t'i frikësojë të dëmtuarit, për çka, përkitazi me këtë, po ashtu, edhe në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme, ku, përveç, që gjykata e shkallës së parë, ka dhënë asyera të qarta duke elaboruar në detaje se përse konsideron se në rastin konkret në veprimet inkriminuese të akuzuarit I. M., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të

paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, e jo të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, dhe ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, në veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, ku, në arsyetim përkitazi me këtë, pra, rikualifikimin në fjalë, ka marrë parasysh sidomos, edhe faktin se i akuzuari në rastin konkret nuk kanë pasur për qëllim privimin nga jeta të dëmtuarit, pra, nuk ka ekzistuar dashja e të akuzuarit që të dëmtuarin ta privojë nga jeta, prandaj, edhe nuk mund të konsiderohej se bëhet fjalë për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, sikur që pretendohet në aktakuzën e prokurorisë, ku, edhe është bërë përshkrimi i veprimeve inkriminuese të akuzuarit, të cilat përbëjnë figurën e veprës penale të vrasjes në tentativë, veprime, pra, që nuk kanë mbështetje në prova e as shkresa tjera të lëndës, për çka, më në detaje u sqarua edhe në arsyerat e cekura më lartë, gjë që, me të drejtë edhe ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, se në rastin konkret nuk mund të flitet për vrasje në tentativë, sikur që pretendohet me aktakuzë të prokurorisë. Prandaj, konstatimi se me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari I. M., ka ndërmarr ndonjë veprim inkriminues në drejtim të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, është i ligjshëm dhe i drejtë, për çka, më në detaje përkitazi me këtë do të bëhet fjalë edhe gjatë elaborimit të pretendimeve ankimore edhe përkitazi me gjendjen faktike në këtë çështje penalo-juridike.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penale dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore në ankesë pretendon se edhe gjendja faktike në këtë çështje penalo-juridike, pra, përkitazi me veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, duke konstatuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, ngase, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se akuzuari I. M., ditën kritike ka shtënë me armë zjarri në drejtim të dëmtuarit me qëllim që ta privojë nga jeta, e që faktet dhe rrethanat në fjalë vërtetohen nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit A. K., të dhënë në polici, ku, deklaroi se i akuzuari ka shtënë në drejtim të tij, fakte këto dhe rrethana që kanë mbështetje edhe në provat materiale, e sidomos, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, vërtetimi për sekuestrimin e armë dhe gëzhojat në vendin e ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, prandaj, me pa mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, për çka, me rikualifikimin e veprës penale në fjalë, për të akuzuarin I. M., në veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, gjykata, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kuptohet në favor të akuzuarit, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit, pra, duke e refuzuar aktakuzën e prokurorisë për shkak të parashkrimit relativ të veprës penale në fjalë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore në fjalë nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të pa kontestuar ka vërtetuar faktet dhe rrethanat e përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit, ku, edhe në bazë të fakteve dhe rrethanave në fjalë, gjykata e shkallës së parë, e ka bërë rikualifikimin e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, në veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, me të vetmin arsyetim se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për të shtëna armësh në drejtim të dëmtuarit e me qëllim që të njëjtin ta privojë nga jeta, pra, për të shtënat me armë zjarri me qëllim të frikësimit të dëmtuarit, prandaj, edhe e ka rikualifikuar veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, në

veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, për çka, arsyerat më në detaje përkitazi me këtë u cekën edhe më lartë tek baza ankimore shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, prandaj, edhe nuk mund të flitet për vërtetim jo të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sikur që pretendon prokuroria në ankesë, ngase, përveç, deklaratës së të akuzuarit edhe nga deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, vërtetohet se i akuzuari ka shtënë me armë zjarri në ajër e jo në drejtim të dëmtuarit, për çka, më pastaj edhe konstatohet se përkitazi me veprën penale në fjalë, pra, veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale, ku, edhe e ka refuzuar akuzën e prokurorisë.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e cekura si më lartë, rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, e sidomos duke pasur parasysh se të akuzuari I. M., nuk ka shtënë me armë zjarri në drejtim të dëmtuarit, por, në ajër dhe atë me qëllim vetëm që ta frikësojë të dëmtuarin, atëherë, gjykata e shkallë së parë, me të drejtë ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit I. M., nuk përmbushen elementet e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, por, të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPPK-së, më pastaj, pasi ka konstatuar se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale për këtë vepër penale edhe e ka refuzuar akuzën e prokurorisë, prandaj, një konkludim i tillë është i drejtë dhe i logjikshëm që do të thotë se drejtë është aplikuar edhe Ligji Penal, dhe nuk ka as shkelje të Ligjit Penal, në favor të akuzuarit, sikur që pretendohet në ankesën e prokurorisë.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, atëherë pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore - DKR në Mitrovicë, se i akuzuari është dashur të shpallet fajtor për vepër penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, qartazi janë të pabazuara dhe të pa argumentuara, e po ashtu, pa mbështetje në prova dhe shkresa tjera të lëndës.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS **PAKR.417/2023, të dt. 29.03.2024**

Procesmbajtëse,
Ardianë Morina

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,
Hashim Çollaku

1. Xhevdet Abazi

2. Kadrije Goga Lubishtani